

Prof. Asoc. Dr. Emrush Thaqi-Kryesues i Këshillit Drejtues

Të nderuar të pranishëm,

Fillimisht familjes së qytetarit të Gjilanit që humbi jetën, të lënduarve dhe qytetarëve të Gjilanit ju shprehi ngushëllimet e sinqerta për ngjarjen e ndodhur dje nga aksidenti i cili ishte një aksident i përmasave tragjike!

I nderuar rektor, anëtar të këshillit drejtues, prorektor, dekan, mësimdhënës, të dashur student, mysafire dhe te gjithë të pranishëm.

Në cilësinë e kryesuesit si dhe në emër të këshillit drejtues ju uroje 6 vjetorin e themelimit të Universitetit “Kadri Zeka” Gjilan,

Universiteti mbanë emrin e një veprimtari të shquar kombëtar Kadri Zeka, një patrioti të madh ku deri në frymën e fundit i kushtojë çështjes kombëtare.

Për këto 6 vite UKZ është konsoliduar dhe është drejtuar në një rrugëtim të mbarë por që ka shumë sfida të cilat duhet të tejkalohen me punë dhe përkushtim të madh.

UKZ është një universitet i ri dhe me një perspektivë evropiane, prandaj ne së bashku duhet të vendosim objektiva të qarta që UKZ të zhvillohet dhe të radhitet në listë të universiteteve me cilësi të larta dhe rezultate të shkëlqyera.

Te nderuar,unë si kryesues së bashku me këshillin drejtues dhe me menaxhmentin e UKZ-së duhet të bëjmë të pamundur që ti bashkërendojmë politikat strategjike në zhvillimin UKZ-së.

Te nderuar te pranishëm UKZ-ja është një mundësi e mire për zhvillimin intelektual të rajonit të Anamoraves, luginës dhe me gjërë andaj kërkohet një profilizim në përputhje me nevojat e tregut të rajonit e më gjërë.....

“Përkushtimi i parë është përkushtimi ndaj cilësisë.

Jo vetëm për të konfirmuar përkushtimin e universitetit tonë ndaj cilësisë, por njëherësh duke shikuar dhe ndarë me të tjerët bindjen dhe vlerësimin tonë se pikërisht cilësia është kryefjala e një rrezatimi pozitiv në këtë mjedis të arsimit të lartë.

Ne duhet të punojmë për një universitet evropian dhe një shoqëri të re...

Faleminderit dhe Suksese, urime!